



Advocacy Center
for **Democratic Culture**

Cika Jovina 3, North City Center, North Mitrovica
+381 (0) 64 1177871, +383 (0) 44 539 852
www.acdc-kosovo.org; office@acdc-kosovo.org

THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË PUNËTORITË PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Nëse jeni të rinj, nxënës të shkollave të mesme ose studentë dhe dëshironi të mësoni për të drejtat e njeriut, të zgjeroni ose shkëmbeni përvoja, të fitoni ose ndërtoni aftësi avokuese aktive dhe t'i promovoni ato në mjedisin tuaj të afërt, atëherë ju ftojmë me shumë kënaqësi të bashkoheni me aktivitetet tona emocionuese, punëtoritë kushtuar të drejtave të njeriut. Këto punëtori ju ofrojnë mundësinë për të zgjeruar njohuritë dhe kuptimin tuaj për rëndësinë e të drejtave të njeriut dhe për t'u përfshirë aktivisht në mbrojtjen dhe promovimin e tyre.

"Shkolla e të Drejtave të Njeriut" është krijuar për t'ju fuqizuar si avokues të të drejtave të njeriut, duke ju ofruar mjetet e nevojshme, informata dhe aftësitë praktike. Nëpërmjet një sërë modulesh edukative, diskutimesh ndërvepruese, studime të rasteve dhe seminare, ju do të merrni një pasqyrë gjithëpërfshirëse në konceptet më të rëndësishme, instrumentet ndërkombëtare dhe kontekstet lokale që lidhen me të drejtat e njeriut. Temat që do të trajtohen në këto punëtori mbulojnë një gamë të gjerë të aspekteve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë mbrojtjen ligjore, barazinë, lirinë e shprehjes dhe shumë tema të tjera me rëndësi themelore. Ekspertët e të drejtave të njeriut do t'ju udhëheqin përmes të gjitha aspekteve tematike, duke përfshirë kornizat ligjore, implikimet e politikave, sfidat sociale dhe aplikimin në botën reale. Do të keni mundësinë të mësoni nga më të mirët, të shkëmbeni ide me bashkëmohatarët dhe të ndërtoni një rrjet bashkëpunimi ndërmjet njerëzve që ndajnë të njëjtin pasion për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Qëllimi i këtyre punëtorive është të rrisë ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut, të ndërtojë një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe të frymëzojë individët që të ndërmarrin hapa konkret për të sjellë ndryshime pozitive në komunitetet e tyre. Përmes shembujve dhe mjeteve praktike, ju do të mësoni se si të aplikoni njohuritë e fituara në botën reale dhe të kontribuoni në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë.

"Shkolla për të Drejtat e Njeriut" do të mbahet në periudhën prej 26 Qershor 2023 deri më 31 Gusht 2023, në ambientet e organizatës sonë në adresën "Rr. Çika Jovina 3", ndërtesa e Hotel North City, Mitrovicë Veriore. Ne ofrojmë një mjedis frymëzues dhe të gjitha burimet e nevojshme për të siguruar një përvojë cilësore gjatë shkollimit. Aplikimet janë të hapura për të gjithë të rinjtë e interesuar, pavarësisht përvojës së mëparshme apo formimit profesional. Dëshira juaj për të mësuar dhe për t'u angazhuar në fushën e të drejtave të njeriut janë kriteret më të rëndësishme. **Shkolla është pa pagesë për pjesëmarrësit e përzgjedhur, që do të thotë se të gjitha shpenzimet për organizimin e orëve dhe aktivitetet e tjera në lidhje me programin mbulohen nga Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike – OJQ ACDC.**

Për të aplikuar vizitoni faqen e internetit www.acdc-kosovo.org dhe plotësoni formularin e aplikimit dhe dërgojeni në email adresën: e-mail konkurs@acdc-kosovo.org me shënimin "Aplikimi për Shkollën për të Drejtat e Njeriut". Formularin mund ta shkarkoni në web-faqen www.acdc-kosovo.org në rubrikën LAJME-NGJARJE/NJOFTIM.

Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve është 10 qershor 2023 deri më 19.06.2023, deri në orën 23:59.

Gjithashtu, për çdo pyetje apo informatë shtesë që mund t'ju nevojitet, ne jemi në dispozicionin tuaj përmes adresës elektronike: ines.aljovic@acdc-kosovo.org. Informata më të detajuara për programin e Shkollës do t'ju jepet atyre kandidatëve që do të ftohen pas përzgjedhjes dhe në bazë të vlerësimit të aplikimeve.